

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE

Nr. prot. _____

Tiranë ___/___/2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

OPERATORIT EKONOMIK “ONE ALBANIA” SH.A.

Adresa: Rr. "Muhedin Llagami", Kompleksi Square 21, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - shërbim.**

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-14202-07-24-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Shërbim për Infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data”.**

Kohëzgjatja e kontratës: Afati kohor i ofrimit të shërbimit është parashikuar për një periudhë kohore prej 855 (tetëqind e pesëdhjetë e pesë) ditë, nga momenti i implementimit/ aktivizimit të shërbimit. Periudha e implementimit/aktivizimit të shërbimit do të jetë deri në 30 (tridhjetë) ditë nga data e nëshkrimit të kontratës/ kontratave brenda marrëveshjes kuadër.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [05.08.2024] [Nr.44].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “VODAFONE ALBANIA” SHA

Emri i plotë i shoqërisë

NIPT K11715005L

Numri i NIPT-t

Vlera **73,222,897** (shtatëdhjetë e tre milion e dyqind e dyzet e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. Operatori ekonomik “ONE ALBANIA” SH.A

NIPT J61814094W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **68,774,075** (gjashtëdhjetë e tetë milion e shtatëind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. Operatori ekonomik “ALBANIAN FIBER TELECOMMUNICATIONS” SHPK NIPT M12212027P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **66,229,417** (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e njëzetë e nëntë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” SH.P.K

NIPT K62115018I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **74,398,015** (shtatëdhjetë e katër milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

5. “GRAMA” SH.P.K

NIPT J77304712J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera - **Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike**

6. OPERATORI EKONOMIK “MC NETWORKING” SH.P.K

NIPT K72223007O

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **53,279,550** (pesëdhjetë e tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori ekonomik “VODAFONE ALBANIA” SH.A

NIPT K11715005L

Për arsyet e mëposhtme:

1. Autoriteti Kontraktor, në Shtojcën 2 “Lista e Cmimeve të Shërbimeve”, (Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik), pjesë e Dokumentave Standarde të Tenderit për këtë procedurë objekt vlerësimi ka bashkëlidhur edhe listën preventive (pa vlerë) me të gjithë zërat dhe tipologjitë e shërbimit (Internet, Dark Fiber, Data Sim Card), objekt kontrate .

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga Operatori Ekonomik “Vodafone Albania” sh.a për përmbushjen e Shtojcës 2, “Lista e Cmimeve të Shërbimeve”, pjesë e DST, rezulton se në plotësimin e Shtojcës 2, operatori ekonomik nuk i është përmbajtur formatit të preventivit (pa vlerë) të publikuar nga AK si pjesë përbërëse e Shtojcës 2 të Dokumentave Standarde të Tenderit të kësaj procedure prokurimi objekt vlerësimi, por ka ofertuar një çmim të përmbledhur me zërin “Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data”.

Duke marrë shkak se tipologjia e shërbimeve, objekt kontrate është e ndryshme, çmimi i ofertuar në total e bën të pamundur identifikimin e çmimeve për secilën tipologji. Ndër të tjera vlen të përmendet gjithashtu se duke qenë se tipi i përzgjedhur i kontratës është “Marrëveshje Kuadër” dhe kërkesat për shërbime do të bëhen sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, oferta sipas Listës së Çmimeve pjesë e Shtojcës 2 të DST është mëse e rëndësishme.

Referuar sa më sipër, K.V.O gjykon se Operatori Ekonomik “Vodafone Albania” sh.a nuk përmbush Shtojcën 2 (Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik), pjesë e Dokumentave Standarde të Tenderit.

2. Autoriteti Kontraktor në pikën 1/b të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit të dokumentave standarde të tenderit, përcakton se:

“ 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3”

Operatori Ekonomik “Vodafone Albania” sh.a nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e pikës 1/b të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit

3. Autoriteti Kontraktor në kriterin 2.3.4 pjesë e kapacitetit teknik kërkon:

“2.3.4 Operatori duhet të ketë të paktën 2 (dy) lidhje ndërkombëtare për shërbimin e Internetit. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të kontratës/marrëveshjes me subjektet jashtë territorit të Shqipërisë mbi përdorimin e Aksesit Global në Internet.”

Operatori Ekonomik “Vodafone Albania” sh.a nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e kriterit 2.3.4.

4. Autoriteti Kontraktor në pikën b të kriterit 2.3.6 pjesë e kapacitetit teknik kërkon:

“2.3.6. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit në linjat kryesore të Institucionit, si dhe në të gjitha vendndodhjet e kërkuara, duhet të përmbushë minimalisht kushtet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjës të certifikuar si më poshtë:

b) Të paktën 2 (dy) teknik të certifikuar SCTE (min certifikim në nivel teknik) ose ekuivalente.”

Operatori Ekonomik “Vodafone Albania” sh.a nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e pikës b të kriterit 2.3.6.

Sa më sipër, KVO konkludon se operatori ekonomik “Vodafone Albania” sh.a nuk ka përmbushur kriterin 1/ b pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, shtojcën 2 të DST, kriterin 2.3.4 dhe pikën b të kriterit 2.3.6 pjesë e kapacitetit teknik.

Sa më sipër, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon njëzëri se oferta e Operatorit ekonomik **“VODAFONE ALBANIA” sh.a.** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme.**

2. Operatori ekonomik “ALBANIAN FIBER TELECOMMUNICATIONS” SHPK NIPT M12212027P

1. Autoriteti Kontraktor në pikën 1/b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të dokumentave standarde të tenderit, përcakton se:

“ 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3”

Operatori Ekonomik “Albanian Fiber Telecommunication” sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e pikës 1/b të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.

2. Autoriteti Kontraktor në pikën 2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumentave Standarde të Tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

“2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës përkatësisht: 148,796,798 (njëqind e dyzet e tetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”.

Operatori Ekonomik “Albanian Fiber Telecommunication” sh.p.k në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka paraqitur dokumentacionin “Vërtetim” (Për xhiron e tre viteve të fundit) me nr. T11288874 datë 28.08.2024 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, në të cilën faktehet situata financiare si më poshtë:

Nr	Periudha Tatimore	Shuma
1	23-A	84,370,821



2	22-A	462,328
3	21-A	0

Nga verifikimi i situatës financiare të paraqitur për 3 (tre) vitet e fundit, KVO gjykon se Operatori Ekonomik “Albanian Fiber Telecommunication” sh.p.k, nuk përmbush kërkesat sipas kriterit 2.2.1 referuar vlerës së xhiros e cila duhet të jetë:

... “ *ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës përkatësisht: 148,796,798 (njëqind e dyzet e tetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH. ...* ”

3. Autoriteti Kontraktor në pikën b të kriterit 2.3.1 pjesë e kapacitetit teknik kërkon:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kontratës objekt prokurimi.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE në përmbushje të kriterit 2.3.1, KVO gjykon se Operatori Ekonomik “Albanian Fiber Telecommunication” sh.p.k nuk përmbush kërkesat sipas kriterit për shërbimet e mëparshme të ngjashme.

4. Autoriteti Kontraktor në kriterin 2.3.2 pjesë e kapacitetit teknik kërkon:

“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrit të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e shërbimit objekt kontrate. Për të vërtetuar këtë kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën/Autorizimin përkatës.

Në përmbushje të kriterit të sipërcituar Operatori Ekonomik “Albanian Fiber Telecommunication” sh.p.k ka paraqitur dokumentin “Certifikatë e Konfirmimit të Njoftimit nr. 2022-AP-01475, datë 04.08.2022 lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në të cilën citohet se OE është rregjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike: “Rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike të njoftuara në AKEP nga sipërmarrësi “Albanian Fiber Telecommunication” sh.p.k:

A. Rrjete publike të komunikimeve elektronike:



1. Rrjete publike tokësore fikse:

a) Rrjeti i aksesit:

- Me fibër optike;*
- Me kabllo koaksial;*
- Me radio*

b) Rrjeti transmetimit

- Me fibër Optike*
- Me kabllo koaksiale;*

c) Zona e njoftuar:

- Bashkitë Tiranë, Durrës, Kavajë dhe Krujë.*

B. Shërbime të komunikimeve elektronike:

- 1. Shërbimi i aksesit në internet;*
- 2. Shërbimi transmetim të dhëna.*
- 3. Shërbimi publik telefonik fiks;*
- 4. Shërbimi i linjave me qera.”*

Gjithashtu, në Formularin e Termave të Referencës Shtojca 7 e Dokumenteve Standarde të Tenderit citohet se: “Autoriteti Kontraktor kërkon të mundësojë nëpërmjet kësaj kontrate ofrimin e shërbimeve:

- *Shërbim internet të dedikuar (500Mbps/500Mbps) për zyrat qendrore dhe zyrat satelite të saj. Zyrat satelite duhet të lidhen direkt (Point-to-Point Dark fiber) me zyrën qendrore me anë të fibrave optike të terminuara në zyrën Qendrore të Bashkisë Tiranë.*
- *Shërbim internet të dedikuar 500/200 Mbps, i cili duhet të terminojë në infrastrukturën qendrore të Bashkisë Tiranë. Kjo linjë do të jetë e dedikuar për ofrimin e shërbimit WiFi (Free) në ambientet publike nën administrim të institucionit ku është vendosur infrastruktura për ofrimin e shërbimit Wifi, për përdorim nga vizitorët, turistët e këtyre ambienteve. Këto ambiente ku do të ofrohet shërbimi WiFi, duhet të lidhen direkt (Point-to-Point Dark fiber) me zyrën qendrore me anë të fibrave optike të terminuara në zyrën Qendrore.*
- *Shërbim internet me gjerësi brezi sipas kërkesave në këtë dokument, të ofruar nëpërmjet teknologjive Fiber Optike, xDSL (aty ku është e pamundur të vendoset fiber optike), Wireless ose ekuivalente, sipas kapaciteteve të përcaktuara në këtë dokument, 50Mbps/50Mbps, 100Mbps/100Mbps, 20Mbps/20Mbps, 30Mbps/5Mbps, Mbps/5Mbps, 16Mbps/3Mbps.*
- *Shërbim internet nëpërmjet Kartave Sim (SIMcard) për të mundësuar aksesimin nga terreni të aplikacioneve në përdorim të Institucionit.*

Referuar sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE në përmbushje të kriterit 2.3.2, KVO gjykon se Operatori Ekonomik “Albanian Fiber Telecommunication” sh.p.k nuk faktin të jetë i rregjistruar pranë regjistrimit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare



për ofrimin e shërbimit “Shërbim internet nëpërmjet Kartave Sim (SIMcard), objekt kontrate, duke mos përmbushur kërkesat e kriterit 2.3.2.

5. Autoriteti Kontraktor në pikën b të kriterit 2.3.6 pjesë e kapacitetit teknik kërkon:

“2.3.6. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit në linjat kryesore të Institucionit, si dhe në të gjitha vendndodhjet e kërkuara, duhet të përmbushë minimalisht kushtet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjës të certifikuar si më poshtë:

b) *Të paktën 2 (dy) teknik të certifikuar SCTE (min certifikim në nivel teknik) ose ekuivalente.”*

Operatori Ekonomik “Albanian Fiber Telecommunication” sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për përmbushjen e pikës b të kriterit 2.3.6.

KVO konkludon se operatori ekonomik “Albanian Fiber Telecommunication” sh.p.k nuk ka përmbushur kriterin 1/b pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, kriterin 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, 2.3.1, 2.3.2 dhe pikën b të kriterit 2.3.6 pjesë e kapacitetit teknik.

Sa më sipër, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit **Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”**, dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Komisioni i Vleresimit të Ofertave konkludon njëzëri se oferta e Operatorit ekonomik **“ALBANIAN FIBER TELECOMMUNICATIONS” SHPK** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme.**

3. “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” SH.P.K NIPT K62115018I

1. Autoriteti Kontraktor në pikën 2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumentave Standarde të Tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

“2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9”.

Gjithashtu, në referencë të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar), pika 1 dhe 2 e këtij neni, kërkohet:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:



- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Në përmbushje të kriterit për kualifikim të sipërcituar, të dokumentave standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt vlerësimi dhe në zbatim të dispozitës ligjore përkatëse operatori ekonomik “Albanian Satellite Communication” sh.p.k nuk ka paraqitur “Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit” sipas Shtojcës 9 të dst.

Për pasojë e sa më sipër, dokumentat e tjera të paraqitura në SPE si pjesë e ofertës së operatorit ekonomik “Albanian Satellite Communication” sh.p.k, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e OE ngelet e pandryshuar.

Në përfundim, KVO konkludon njëzëri se Operatori Ekonomik “Albanian Satellite Communication” sh.p.k, s’kualifikohet nga procedura e prokurimit me objekt “Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data”.

Sa më sipër, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon njëzëri se oferta e Operatorit ekonomik “ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS” SHPK nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

4. OPERATORI EKONOMIK GRAMA” SH.P.K NIPT J77304712J

1. Autoriteti Kontraktor në pikën 2 të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumentave Standarde të Tenderit, përcakton se ofertuesi duhet të paraqesë:

“2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9”.

Gjithashtu, në referencë të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 (i ndryshuar), pika 1 dhe 2 e këtij neni, kërkohet:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;



- c) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Në përmbushje të kriterit për kualifikim të sipërcituar, të dokumentave standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt vlerësimi dhe në zbatim të dispozitës ligjore përkatëse operatori ekonomik “Grama” sh.p.k nuk ka paraqitur “Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit” sipas Shtojcës 9 të dst.

Për pasojë e sa më sipër, dokumentat e tjera të paraqitura në SPE si pjesë e ofertës së operatorit ekonomik “Grama” sh.p.k, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e OE ngelet e pandryshuar.

Në përfundim, KVO konkludon njëzëri se Operatori Ekonomik “Grama” sh.p.k, s’kualifikohet nga procedura e prokurimit me objekt “Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data”.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit **Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”**, dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon njëzëri se oferta e Operatorit ekonomik



“GRAMA” SHPK nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme.**

5. Operatori ekonomik “MC NETWORKING” SH.P.K NIPT K722230070

1. Autoriteti Kontraktor në kriterin 2.3.2 pjesë e kapacitetit teknik kërkon:

“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrimit të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e shërbimit objekt kontrate. Për të vërtetuar këtë kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën/Autorizimin përkatës.

Në përmbushje të kriterit të sipërcituar Operatori Ekonomik “MC Networking” sh.p.k ka paraqitur dokumentin “Certifikatë e Konfirmimit të Njoftimit nr. 2023-AP-1.1_640”, datë 03.10.2023 lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në të cilën citohet se OE është rregjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike si më poshtë:

“Rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike të njoftuara në AKEP nga sipërmarrësi “MC NETWORKING” sh.p.k:

I. Rrjete publike të komunikimeve elektronike:

1. Rrjete publike tokësore fikse:

a) Rrjeti i aksesit:

- Me fibër optike;
- Me përcjellsa metalikë;
- Me radio.

b) Rrjeti transmetimit

- Me fibër Optike
- Me përcjellsa metalikë

c) Zona e njoftuar e rrjetit:

- 61 bashkitë e vendi

B. Shërbime të komunikimeve elektronike:

1. Shërbimi i aksesit në internet;

2. Shërbimi transmetim të dhënash.

2. 3. Shërbim publik telefonik fiks;

3. -Zë (thirrje locale, thirrje kombëtare, thirrje ndërkombëtare).”

Gjithashtu, në Formularin e Termave të Referencës Shtojca 7 e Dokumenteve Standarde të Tenderit citohet se Autoriteti Kontraktor kërkon të mundësojë nëpërmjet kësaj kontrate ofrimin e shërbimeve:



- *Shërbim internet të dedikuar (500Mbps/500Mbps) për zyrat qendrore dhe zyrat satelite të saj. Zyrat satelite duhet të lidhen direkt (Point-to-Point Dark fiber) me zyrën qendrore me anë të fibrave optike të terminuara në zyrën Qendrore të Bashkisë Tiranë.*
- *Shërbim internet të dedikuar 500/200 Mbps, i cili duhet të terminojë në infrastrukturën qendrore të Bashkisë Tiranë. Kjo linjë do të jetë e dedikuar për ofrimin e shërbimit WiFi (Free) në ambientet publike nën administrim të institucionit ku është vendosur infrastruktura për ofrimin e shërbimit Wifi, për përdorim nga vizitorët, turistët e këtyre ambienteve. Këto ambiente ku do të ofrohet shërbimi WiFi, duhet të lidhen direkt (Point-to-Point Dark fiber) me zyrën qendrore me anë të fibrave optike të terminuara në zyrën Qendrore.*
- *Shërbim internet me gjerësi brezi sipas kërkesave në këtë dokument, të ofruar nëpërmjet teknologjive Fiber Optike, xDSL (aty ku është e pamundur të vendoset fiber optike), Wireless ose ekuivalente, sipas kapaciteteve të përcaktuara në këtë dokument, 50Mbps/50Mbps, 100Mbps/100Mbps, 20Mbps/20Mbps, 30Mbps/5Mbps, Mbps/5Mbps, 16Mbps/3Mbps.*
- ***Shërbim internet nëpërmjet Kartave Sim (SIMcard) për të mundësuar aksesimin nga terreni të aplikacioneve në përdorim të Institucionit.***

Referuar sa më sipër, KVO gjykon se:

Për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, Operatori Ekonomik duhet ta vërtetojë duke dorëzuar Certifikaten/Autorizimin përkatës nga AKEP, bazuar në përcaktimet e Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar) dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrime specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

AKEP rezervon të drejtën të autorizojë një sipërmarrës/subjekt të ofrojë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun. Gjithashtu, AKEP monitoron të gjithë infrastrukturën e çdo operatori, i cili e ka të detyrueshme paraqitjen e shtrirjes së rrjetit të tij pranë AKEP sipas teknologjisë përkatëse që operatori disponon.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE në përmbushje të kriterit 2.3.2, Operatori Ekonomik “MC Networking” sh.p.k nuk fakton të jetë i rregjistruar pranë regjistrimit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e shërbimit internet nëpërmjet SimCard konkretisht për shërbimin “**Shërbim internet nëpërmjet Kartave Sim (SIMcard)**”, objekt kontrate, duke mos përmbushur kërkesat e kriterit 2.3.2.

Sa më sipër, KVO konkludon se operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k nuk përmbush kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik.

Sa më sipër, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit

të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon njëzëri se oferta e Operatorit ekonomik “MC Networking” sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**Operatori ekonomik “ONE ALBANIA” SH.A** me adresë: Rr. "Muhedin Llagami", Kompleksi Square 21, Tiranë], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **68,774,075** (gjashtëdhjetë e tetë milion e shtatëind e shtatdhjetë e katër mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Zëvendëskryetar / Person i autorizuar